

# Albanian News Agency

## AlbPress

HOME KRYESORE POLITIKE EKONOMI AKTUALITET ANALIZE REPORTAZH SPORT BOTA TE DOBISHME KULTURE

RRETH NESH INFO KONTAKT

Humb jetën 53 vjeçarja, nisin hetimet » **FLASH NEWS** P/buxheti, priten debate pozitë-opozitë » Neonazistët, qeve:

MARKETING



### Bashkia e Tiranës, kontroll tregjeve për lëndët plasëse



Bashkia e Tiranës nisi një aksion në të gjithë qytetin për kontrollin e shitjes së lëndëve me rrezikshmëri, veçanërisht ato plasëse dhe helmuese. Këto inspektime do të vijojnë në mënyrë periodike për të arritur një kontroll të plotë për standartet e sigurisë në tregëtimin e këtyre lëndëve, për të garantuar jetën e qytetarëve.

“Aksioni është shtrirë në 4 pikat kryesore ku tregtohen këto produkte, siç është tregu çam, sheshi “Avni Rustemi”, tek Medreseja dhe më poshtë tek Stacioni i Trenit, 4 pika ku sistematikisht tregtohen këto produkte të rrezikshme, lëndë plasëse, ndezëse. Ne do të vazhdojmë kontrollet edhe për produkte të cilat kanë përbërje helmuese, kimike, insecticide, pesticide, në mënyrë që të rrisim standartin e shërbimit ndaj qytetarit të Tiranës dhe mbi të gjitha cilësinë dhe të sigurojmë jetën e tyre”, u shpreh Drejtori i Agjencisë për Mbrojtjen e Konsumatorit në Bashkinë e Tiranës, Geron Ibrahim.

Aksioni po kryhet në bashkëpunim të plotë me strukturat e Zjarrfikësve si dhe të Policisë Bashkiake. Drejtori i Zjarrfikësve, Dilaver Laçi u shpreh se do të bashkëpunohet ngushtë me Bashkinë e Tiranës për të parandaluar çdo lëndë ndesëse e tregtuar jashtë kushteve të lejuara me ligj. “Së bashku me Policinë Bashkiake, Agjencinë për Mbrojtjen e Konsumatorit, ne do të vazhdojmë të kontrollojmë të gjithë bizneset. Pragu i vitit të Ri ka një rrezik të shtuar për fishekzjarrët dhe mjetet e tjera ndezëse. Për këtë arsye, në ditët në vijim do të ketë një kontroll më të rreptë nga ana e shërbimit Zjarrfikës dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, ndërkohë që edhe me Policinë Bashkiake ka një bashkëpunim shumë të mirë”, tha Laçi.

Të ngjashme...



**Transporti urban, Bashkia operatorëve: Respektoni oraret, do t'ju hiqet licens**  
...



**Lirimi i trotuareve, Policia Bashkiake vijon aksionin**



**Rama: Qeveria i ka ditët e numuruara**



**Ndërtimet pa leje, Bashkia e Tiranës nis kontrollet. Kërkohet bashkëpunimi me**  
...



**Dita pa makina, Basha fton qytetarët të ecin në këmbë ose me biçikletë**



KOMENTONI »

Emri ()

Email (nuk do te publikohet)()

Adresa e Internetit

#### MË TË LEXUARAT SOT

- Kandidatet femra për Shkollën e Policisë, datat ku...
- Dëmshtëpërlimi i ish-të përndjekurve, kësti i dytë ...
- Ndotja e ajrit në nivele të larta. Ndikimi në shën...
- Hajduti i shkruan viktimave: Unë ju vjedh, por faj...
- Vendimi, lista dhe masa e dëmshtëpërlimit për 557 i...
- Taksat e makinave, sa duhet paguar gjatë një viti...
- Ish-të përndjekurit, udhëzim i ri për dëmshtëpërlim...
- Nxehet Topi, akuza Berishës: Ka humbur kontrollin...

#### LAJMET E FUNDIT

- Humb jetën 53 vjeçarja, nisin hetimet
- P/buxheti, priten debate pozitë-opozitë
- Spiunë të djathtë apo informatorë?
- Kreditë, Moody's i ul Hungarisë shkallën e besueshmërisë
- Neonazistët, qeveria kërkon struktura të reja
- Spears e çmendur pas çokolletës, lë edhe palestrën
- Bode: P/buxheti, ja pse jemi të bindur për rritjen ekonomike

#### GALERIA E FOTOVE



**Spiunë të djathtë apo informatorë?**



**Spears e çmendur pas çokolletës, lë edhe palestrën**



**Bode: P/buxheti, ja pse jemi të bindur për rritjen ekonomike**



**Kandidatet femra për Shkollën e Policisë, datat kur do të bëhet testimi. Lista e plotë, sipas kodeve**



**Fule pret Ramën në Bruksel: Integrimi European të kthehet në një axhendë kombëtare**



**TI: Partive t'i kontrollohet burimi i financimit**

POST COMMENT

[POLITIKE](#) [EKONOMI](#) [AKTUALITET](#) [ANALIZE](#) [REPORTAZH](#) [SPORT](#) [BOTA](#) [TE DOBISHME](#) [KULTURE](#)

[RRETH NESH](#) [INFO](#) [KONTAKT](#) [MARKETING](#) [RSS](#)

[Log in](#) | [Dizenjuar nga GSC](#)  
[View in: Mobile](#) | [Standard](#)

